

	REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije Ministry of Finance Arkiva - Arhiva - Archive
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	01
Nr. i fajeve Broj stranica No. pages.	9
Dalëse	
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No:	1014
Dara Datum Date:	15, 05, 2014
PRISHTINË/A	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije / Ministry of Finance

Zyra e Ministrat / Kancelarija Ministra / Cabinet of the Minister

DATË/A:	15 MAJ 2014
PËR/ZA/TO:	Ministrat Udhëheqësit e Organizatave buxhetore Zyrtarët për buxhet të organizatave buxhetore
NGA/OD/FROM:	Besim Beqaj, Ministër në Ministrinë e Financave
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkorja buxhetore 2015/01. Përgatitjet e para dhe kufijtë fillestar për Buxhetin e viti 2015 nga Organizatat buxhetore Qendrore

**Të nderuar Ministra,
Të nderuar Udhëheqës dhe Zyrtar për buxhet,**

Më lejoni që në fillim të procesit të hartimit të buxhetit për vitin 2015, të ju falënderojë për punën e përbashkët të bërë në hartimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2015-2017. Shpresojë se puna e përbashkët në hartimin e KASH-it, do të na shërbejë të jemi të suksesshëm edhe në një proces shumë të rëndësishëm për ne që ka të bëjë më hartimin e buxhetit për vitin 2015.

Ministri për Financa është i autorizuar dhe përgjegjës që në përputhje me Nenin 20 të LMFPP, të nxjerrë qarkore buxhetore për cilëndo ose të gjitha organizatat buxhetore, me të cilat sigurohen udhëzime për përgatitjen e Buxhetit të Kosovës. Në mbështetje të kësaj dispozite ligjore, Ministri nxjerr Qarkoren buxhetore 2015/01 ku ofrohen udhëzimet e para për hartimin e buxhetit për vitin 2015 dhe vlerësimet për vitet 2016-2017, kalendarin kohor indikativ si dhe kufijtë fillestar të përgatitjes së buxhetit për vitin 2015 dhe vlerësimet për vitet 2016-2017 për çdo Organizatë buxhetore. Kjo Qarkore u ndihmon organizatave buxhetore në procesin buxhetor gjatë muajve të ardhshëm. Pas kësaj qarkoreje do të pasohen qarkore tjera shtesë, sipas nevojës.

Konteksti për përgatitjen e buxhetit 2015

Buxheti për vitin 2015 përgatitet në një kohë kur tani ma është aprovuar KASH-i 2015-2017. Dokumenti i KASH-i 2015-2017, i miratuar nga Qeveria më 29 Prill 2014 përmban prioritetet afatmesme të Qeverisë dhe tavanet indikative të shpenzimeve për vitet 2015-2017. Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar që në rend të parë të ruajë stabilitetin fiskal dhe

buxhetor dhe të përkrah brenda kornizave kërkesat e organizatave buxhetore dhe prioriteteve të saja të dala nga dokumentet “Plani i punës së qeverisë” dhe “Vizioni dhe Prioritetet e zhvillimit ekonomik”.

Në linjë me prioritetet e përcaktuara përmes Deklaratën e Prioriteteve të Politikave Afatmesme (DPPA-së), gjatë zhvillimit të KASH-it 2015-2017, ne do të duhet të marrim parasysh edhe zotimet tona në raport me institucionet ndërkombëtare. Në këtë kontekst, Qarkorja buxhetore si vazhdimësi e KASH-i 2015-2017 do të hartohet në pajtim me politikat fiskale - buxhetore për të cilat Qeveria ka diskutuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN).

Megjithatë, në përpjekje për të siguruar që profili i shpenzimeve përshtatet më mirë me prioritetet e Qeverisë, do të jetë e nevojshme që brenda një organizate buxhetore apo edhe brenda një sektori të ketë lëvizje të prioriteteve për të lejuar hapësirën e nevojshme fiskale për të rritur financimin për programet dhe projektet me prioritet.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH)

Duke u mbështetur në obligimet që dalin nga Ligji për ndryshim dhe Plotësim e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, Nenit 5, Qeveria e Republikës së Kosovës i ka dorëzuar Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) për periudhën 2015-2017.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2015-2017, paraqet një nga shtyllat më të rëndësishme të planifikimit dhe procesit buxhetor. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve nga viti në vit ka avancuar duke mos paraqitur më vetëm një kornizë buxhetore, por tashmë është shëndruar në instrument të rëndësishëm të prioritizimit dhe realizimit të politikave të Qeverisë, duke i paraprirë hartimit të Buxhetit.

Kjo kornizë është hartuar duke marrë për bazë, ashtu sikurse edhe në vitin 2014, politiken e re të inkorporuar në Plotësim-ndryshimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, atë të kufizimit të deficitit buxhetor në 2% të Bruto Produktit Vendor. Në këtë kontekst, supozimet për fillim të implementimit të rregullës fiskale nga viti 2014 e tutje, kanë kushtëzuar planifikimin e matur të shpenzimeve publike. Po ashtu pjesë e shpenzimeve të përgjithshme të definuara me këtë Kornizë është edhe vlera e huamarrjeve të jashtme për projekte specifike gjatë kësaj periudhe.

Sic u cekë edhe më lartë, projekcionet e të hyrave buxhetore bazohen në vlerësimet afatmesme të indikatorëve kryesor makroekonomik, përfshirë këtu lëvizjet e importit, çmimeve si dhe vlerësimet mbi rritjen e përformançës së institacioneve përgjegjëse në ngushtimin e hendekut tatimor dhe zgjerimin e bazës tatimore për mbledhjen e të hyrave.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve e aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës është në dispozicion të organizatave buxhetore si udhërrëfyes për zhvillimin e buxheteve të tyre. Dokumenti i KASH-it, është dokument që reflekton raportin në mes politikave qeveritare dhe procesit buxhetor. Ky dokument ka për qëllim të përcaktojë objektivat specifike për çdo organizatë buxhetore në mënyrë që këto objektiva të ndihmojnë në arritjen e prioriteteve të organizatës buxhetore. Po ashtu ky dokument do të shërbejë për hartimin e buxhetit sepse përmes procesit buxhetor tani kërkohet që objektivat specifike nga dokumenti i KASH-it të zhvillohen në aktivitete specifike dhe projekte individuale që zhvillohen në nivel të programeve dhe nën-programeve për financim. Të gjitha këto objektiva duhet zhvilluar

brenda projeksiioneve makro-fiskale për periudhën tri vjeçare për vitin buxhetor pasues dhe për dy vitet e ardhshme.

Është obligim i çdo organizate buxhetore që me rastin e përgatitjes së kërkesave të saj të sillet brenda kornizave të lejuara buxhetore, brenda dokumentit të KASH-it dhe deklaratës së Prioritetave Afatmesme të Qeverisë. Tani përmes procesit buxhetor (Qarkores së parë) kërcohët që Organizatat buxhetore të reflektojnë në përgatitjen e financimit në nivel të programeve dhe nën-programeve, aktivitetave dhe projekteve individuale.

Për periudhën 2015-2017 Qeveria është zotuar të rrisë ndarjet për Paga si dhe të ndajë më shumë mjete për Subvencione e transfere duke rritur ndarjet për Skemat Sociale dhe Pensionale, mbështetjen për sektorin e bujqësisë. Për më tepër, Qeveria synon që në periudhën afatmesme të vazhdoj me financimin e mëtejshëm për mbështetjen investimeve në infrastrukturën rrugore, duke përfshirë ndërtimin e Rrugës 6 (rruga Prishtinë- Hani i Elezit) dhe forcimin e rendit dhe sigurisë, të gjitha këto të integruara në një kornizë të qëndrueshme afatmesme buxhetore.

Për të implementuar këto politika, krahas rritjes së të hyrave buxhetore, Qeveria synon të zvogëlojë ndarjet buxhetore për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve krahasuar me ndarjet për vitin 2014.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve do të përfshijë totalin e shpenzimeve të planifikuara buxhetore si dhe burimet e financimit të shpenzimeve të përgjithshme si: të hyrat e rregullta buxhetore, financimet nga kreditë, grantet e donatorëve dhe financimet tjera.

Procesi buxhetor 2015-2017

Procesi buxhetor për vitet 2015-2017 sikur që është sqaruar edhe përmes dokumentit të KASH 2015-2017, për dallim nga vitet e kaluara, këtë vit është hartuar duke marrë për bazë skenarin bazë të shpenzimeve. Rregulli i përgjithshëm i vlerësimeve afatmesme për skenarin bazë të shpenzimeve paraqet vazhdimesinë e financimit të programeve në nivel aktual të shërbimeve si dhe implementimin e politikave tani më të miratuara nga Qeveria. Ky skenar bazë sipas organizatave buxhetore nënkupton nivelin e aprovuar të punësimit dhe të pagave, uljen e shpenzimeve në kategorinë ekonomike të mallrave dhe shërbimeve dhe shpenzimeve komunale sipas politikave të reja të Qeverisë si dhe projektet kapitale të cilat janë projekte të vazhdueshme nga viti 2014 dhe më herët. E tërë kjo me qëllim të implementimit të vendimeve të Qeverisë si dhe të krijimit të hapësirës fiskale për financimin e politikave të reja (rritje të pagave, pensioneve, rritje të subvencioneve për bujqësi, implementim të Ligjit për Sigurimet shëndetësore dhe politikave tjera që kanë të bëjnë me Sektorin e rendit dhe sigurisë) që Qeveria i ka paraparë në Deklaratën e Prioritetave të Politikave Afatmesme 2015 – 2017.

Organizatat buxhetore duhet të kenë parasysh që gjatë përgatitjes së kërkesave të tyre t'u jepet prioritet:

- Projekteve të cilat ndihmojnë në realizimin e prioriteteve të Qeverisë,
- Projekteve të cilat janë në vazhdimesi nga vitet paraprake,
- Zotimet e Qeverisë për Planin e Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimiit dhe programin – Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA),
- Legjislacioni i ri apo ndryshim plotësimi i atij ekzistues,

- Të përfshijnë brenda ndarjeve buxhetore obligimet për financim të jashtëm të projekteve individuale,
- Organizatat buxhetore duhet të kujdesen që të hyjnë në obligime për bashkëfinancim vetëm deri në nivelin që lejon korniza e tyre buxhetore.

Qarkorja e parë buxhetore 2015/01 përmban kufijtë për shpenzimet operative dhe shpenzimet kapitale në nivel të organizatës buxhetore (shiko Aneksin 1) për fillimin e hartimit të buxhetit për vitin 2015 dhe vlerësimet për vitet 2016 dhe 2017 të pasqyruara në KASH. Këta kufij buxhetor mund të ndryshojnë varësisht nga lëvizjet fiskale apo vendimet e Qeverisë të cilat do të pasqyrohen përmes Qarkoreve pasuese si dhe kualitetit të kërkesave buxhetore të cilat duhet të përgatitën mbi bazën e indikatorëve të përfomancës (rezultateve dhe produkteve të pritshme).

Duhet pritur që në procesin e hartimit të buxhetit, Qeveria të kërkojë që të ndryshojë profilin e shpenzimeve me qëllim të arritjes së prioriteteve të saj, pra të reduktojë financimin për projektet jo-prioritare në të mirë të programeve apo projekteve që ndihmojnë arrijen e objektivave strategjike të Qeverisë. Kjo mund të kërkojë zhvendosje të tavaneve brenda programeve të Organizatës buxhetore, por një zhvendosje të tillë mund të kërkonte edhe mes Organizatave buxhetore.

Kërkesat buxhetore duhet të mbështesin politikat prioritare të Qeverisë të vendosura në KASH, të cilat do të krijojnë parakushte përritje të qëndrueshme ekonomike, përmirësim të mjedisit përbrenda të cilit zhvillohen aktivitetet e shtuara të sektorit privat, përkrahje të sundimit të ligjit, luftë kundër korruptionit, reformat institucionale, përmirësim të pozitës sociale të kategorive më të prekura sociale. Implementimi i këtyre prioriteteve do të kontribuoj në Integrimin Evropian të Kosovës.

Organizatat buxhetore rekomandohet të formojnë grupe punuese për hartimin e kërkesave buxhetore me pjesëmarrës të stafit civil dhe politik me qëllim të sigurimit që kërkesat buxhetore mbështesin Programin e Qeverisë dhe dokumentet tjera strategjike të Qeverisë.

-Ndryshimi brenda shpenzimeve operative për vitin 2015 për të kursyer nga kategoria e mallërave dhe shërbimeve dhe rritjen e pagave është prioritet për Qeverinë. Organizatat buxhetore duhet të ofrojnë kërkesat e tyre përbrenda mundësive buxhetore. Është thelbësore që të gjitha organizatat buxhetore t'u përbahen kufijve të dhënë në KASH dhe shtojcën e bashkangjitur për vitet 2015-2017. Këto janë shumat maksimale që lejon korniza fiskale bazuar në politikat e tanishme të Qeverisë.

Shpenzimet operative për vitin 2015 dhe vlerësimet për vitet 2016-2017 do të pësojnë ngritje në krahasim me vitin 2014. Kjo me qëllim të implementimit të vendimit të Qeverisë përritje të pagave dhe pensioneve, vendim i cili ka filluar të implementohet këtë vit për periudhën nëntë mujore krahasuar me vitin e ardhshëm që do të përfshinë një vit të plotë buxhetor. Gjithashtu nga viti 2015, parashihet të filloj edhe implementimi i ligjit për Sigurime Shëndetësore, i cili legjislacion pritet të ketë një kosto shtesë për vit rrëth €18.3 milion. Këto mjete tani për tani janë planifikuar në kuadër të Ministrisë së Financave (MF) dhe në momentin e fillimit të implementimit të tij, këto mjete do të barten nëpër organizata buxhetore.

-Punësimi dhe pagat e mëditjet - sipas projeksjoneve në Kornizën Makro- Fiskale 2015-2017, kategoria ekonomike e cila do të ketë më së shumti ngritje krahasuar me vitin 2014, do të jetë

kategoria e pagave dhe mëditjeve. Kjo, ashtu edhe siç është cekur më lartë, me qëllim të implementimit të vendimit të Qeverisë për rritje të pagave. Këto mjete tani për tani, janë planifikuar në kuadër të MF-së, si kontigjencë për paga, në shumë prej rreth €55.4 milion për rritjet e parapara për Nivelin qendror, për Nivelin komunal janë paraparë mjetet te ndarjet komunale. Në momentin e pranimit të shënimive për shpërndarje të pagave dhe mëditjeve, nga Ministria e Administratës Publike (MAP), këto mjete do të barten nëpër organizata buxhetore përmes procesit buxhetor. Megjithatë një gjë e tillë nuk nënkupton edhe ngritjen e numrit aktual të të punësuarve, i cili parimi shi mbetet në nivel të njejtë të vitit paraprak, duke pësuar kështu ngritje me rastin e implementimit të Reformës së Sektorit të Sigurisë.

-Mallrat dhe shërbimet - do të përcillen me një zbritje krahasuar me buxhetin e aprovuar të vitit 2014. Një zbritje e tillë paraqitet me qëllim të vazhdimit të implementimit të vendimit të Qeverisë për shkurtimin e kategorive ekonomike të mallrave dhe shërbimeve si dhe shpenzimeve komunale i cili ka për qëllim krijimin e hapësirës fiskale për financimin e politikave të reja të Qeverisë dhe në funksion të rritjes së efikasitetit të shpenzimeve.

-Subvencionet dhe transferet - kjo kategori në total do të ketë rritje të ndjeshme për shkak të implementimit të vendimit të Qeverisë për rritje të pensioneve prej 25% me përjashtim të rritjes së pensioneve të pensionistëve të Trepçës 50%, të vazhdimit të implementimit të skemave që kanë të bëjnë me veteranët e luftës dhe ish të përndjekurit politik si dhe të nivelit të shtimit natyror të numrit të pensionistëve. Gjithashtu në këtë rritje ka ndikim edhe vazhdimi i përkrahjes së financimit të sektorit të bujqësisë nga subvencionimet, përmes politikave të Qeverisë. Ajo që vlen të ceket është se subvencionet për Ndërmarrje publike do të kenë ulje në ndarjet buxhetore sepse pritet që disa prej tyre të privatizohen, kurse ndërmarrjet tjera të kenë një performancë më të mirë në menaxhimin e shpenzimeve dhe ngritjen e të hyrave.

-Shpenzimet kapitale - kjo kategori e shpenzimeve edhe përgjatë periudhës së projektuar do të vazhdojë të përfaqësoj një pjesë të rëndësishme të shpenzimeve të përgjithshme. Nën supozimin e ekzekutimit të plotë të këtyre shpenzimeve kjo kategori pritet të përbëjë rreth 27% të shpenzimeve totale apo rreth 8.1% të BPV-së në mesatare për periudhën 2015-2017. Kjo kategori e shpenzimeve në kuadër të shpenzimeve të rregullta buxhetore, ka potencialin më të madh për të nxitur rritjen ekonomike. Sektorët kryesor që do të vazhdojnë të përkrahen janë, infrastruktura rrugore, ndërtimi i objekteve për arsim, projekte të rëndësishme për zhvillimin e sektorit të energjisë dhe sektorëve tjera.

Në kuadër të shpenzimeve kapitale dhe kornizës së prezantuar fiskale është integruar edhe projekti i ndërtimit të Rrugës 6 Prishtinë –Shkup si dhe do të vazhdon edhe financimi i projekteve tjera të rëndësishme në infrastrukturë si në rrugën M2 dhe M9.

Projektet kapitale duhet të planifikohen në bazën shumëvjeçare dhe duke u mbështetur në kufijtë e dhënë buxhetor. Projektet kapitale duhet të përbajnë edhe pjesën e shpenzimeve operative që është pjesë e atij projekti dhe duhet të paraqitet përmes formave standarde të PIP-it.

Ministria e Financave është duke punuar me të gjithë sektorët që të ngritet kujdesi në planifikimin dhe efikasitetin e shpenzimit të parasë publike, në mënyrë që të ofrohen shërbime publike më të mira për qytetarët e Kosovës.

Projektet e propozuara kapitale do të vlerësohen në kontekst të elementeve në vijim:

Përparësi për financim do të kenë projektet në vazhdim dhe ato të cilat janë në harmoni të plotë me prioritet e dhëna nga Qeveria e Republikës së Kosovës, objektivave strategjike të reflektuara në dokumentin e KASH-it si dhe të paraqitura përmes formave standarde të PIP-it e që kanë deklaruar arsyeshmëri të plotë për financim.

Të gjitha projektet kapitale duhet të përgatiten mbi bazën e përformancës buxhetore duke paraqitur analizën **kost-benefit** për çdo projekt kapital mbi vlerën prej €400,000 për projektet e vitit 2015. Kjo do të thotë që të gjitha projektet kapitale qoftë të vazhdueshme apo projekte te reja që kalojnë shumën brenda një vitit prej €400,000 duhet të kenë analizën kost-benefit. Kufijtë buxhetor për shpenzime kapitale duhet të konsiderohen si kufij të vlerësuar dhe varësisht nga arsyeshmëria e kërkesave këta kufij mund të ndryshojnë gjatë ciklit buxhetor.

Nga kjo që u tha më lartë fokusi i prezantimit të kërkesave buxhetore duhet të jetë arsyeshmëria e financimit të projekteve kapitale mbi bazën e fizibilitetit të projekteve dhe analizës kost-benefit.

Indikatorët e performancës

Për secilin program dhe për secilin projekt, organizatat buxhetore duhet të prezantojnë draftin e indikatorëve të performansës. Në mënyrë specifike, për secilin program duhet të ekzistojë:

- Të paktën një indikator specifik i rezultatit,
- Të paktën dy masa të produktit,
- Një masë të efikasitetit për secilin produkt.

“Rezultatet” janë objektiv i politikës për të cilën ekziston programi. Për shembull, programi për imunizim të fëmijëve ekziston për të çrrënjosur një sëmundje. Indikator i duhur i performansës së atij rezultati për këtë program do të ishte numri i diagnostikuar i rasteve të sëmundjes gjatë vitit.

“Produktet” janë produktet apo shërbimet e ofruara nga një program i qeverisë. Duke përdorur shembullin e mësipërm të imunizimit, produktet janë dhënia e vaksinave fëmijëve. Një masë e mirë e produktit për atë program të imunizimit do të ishte numri i vaksinave të dhëna gjatë vitit.

Masat e “efikasitetit” janë masa statistikore të nivelit të inputeve për secilën njësi të produktit. Duke përdorur shembullin e mësipërm të imunizimit, masë e efikasitetit do të ishte kostoja mesatare e çdo vaksinimi (që përfshin koston e vaksinës dhe koston tjetër direkte dhe indirekte sikur që është kostoja e stafit, etj).

Inkurajoheni që të kontribuoni në ngritjen e efektivitetit dhe transparencës së shpenzimit të parasë publike duke paraqitur sa më shumë indikatorë të veçantë të performancës që është e mundur. Në mënyrë për ta bërë këtë është që indikatorët dhe masat që lidhen me individët të ndahen sipas grave dhe burrave në të gjitha rastet ku kjo ndarje është e mundshme dhe ka kuptim.

Për shembull, indikatori i rezultateve “numri i punëkërkuesve të punësuar pas trajnimit” mund të ndahet në “numri i punëkërkuesve femra të punësuar pas trajnimit” dhe “numri i punëkërkuesve meshkuj të punësuar pas trajnimit”.

Ngashëm edhe masat e produktit mund të bëhen më specifike duke bërë ndarjen e tyre. Në shembullin e mësipërm një masë e produktit do të ishte “numri i punëkërkuesve që marrin

pjesë në trajnim” mund të ndahet më tutje në “numri i punëkërkueseve femra që marrin pjesë në trajnime” si dhe “numri i punëkërkuesve meshkuj që marrin pjesë në trajnime”.

Gjithashtu masat e efikasitetit mund të jenë më shumë informuese në nivele të caktuara, nëse kostoja ndahet sipas femrave dhe meshkujve, posaçërisht nëse ka dallime në produktet dhe shërbimet e ofruara për femrat dhe meshkujt, p.sh. nëse femrat dhe meshkujt nuk marrin pjesë programet e trajnimeve për tregun e njëjtë të punës. Në këtë rast ndarja e masës së efikasitetit do të ishte “kosto mesatare e trajnimit për tregun e punës për femra” dhe “kosto mesatare e trajnimit për tregun e punës për meshkuj”. Më lejoni t’ju përkujtoj se për përgatitjet e buxhetit për vitin 2015, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është zotuar se do t’i kushtojë vëmendje të veçantë vënies në dukje të përpjekjeve të bëra për barazinë e femrave dhe meshkujve në kontekstin e buxhetimit (Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor). Organizatat tjera buxhetore inkurajohen që të veprojnë njëjtë. Bazuar në përvojën nga pilot projekti në MPMS, në vitet në vijim Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor do të zgjerohet edhe në organizatat tjera buxhetore.

Disa nga treguesit e përfomancës që mundësojnë që të gjitha ndarjet buxhetore të arsyetojen janë:

- Treguesit për të matur kuantitetin
- Treguesit për të matur kualitetin
- Treguesit për të matur efektshmerinë
- Treguesit për të matur prodhimtarinë
- Treguesit për të matur vlerën për para
- Indikatorët për matjen e barazisë ndërmjet femrave dhe meshkujve

Më lejoni të ju njoftojë se kërkesat për paraqitjen e indikatorëve të përfomancës përmes këtyre treguesve janë kërkesë e përhershme e IFN dhe KE për të matur përfomancën e përgjithshme të procesit buxhetor.

Indikatorët e përfomancës ju lutemi i paraqitni të përbledhura sipas objektivave që ka çdo Organizatë buxhetore

Shtojca 2: përmban orarin dhe kalendarin e procesit buxhetore 2015, që është i bashkangjitur kësaj Qarkoreje.

Programi për investime publike (PIP)

Planifikimi i buxhetit për investime kapitale bëhet përmes sistemit të PIP-it. Është e rëndësishme që prioritetet strategjike të Qeverisë ashtu si janë paraqitur në “ deklaratën e prioriteteve të politikave të Qeverisë 2015-2017” brenda dokumentit të KASH-it të janë bazë për përgatiten e kërkesave buxhetore dhe identifikim të projekteve kapitale.

Të gjitha Organizatat buxhetore duhet të arsyetojnë plotësisht kërkesat e veta buxhetore për projektet e tyre përmes sistemit të PIP-it.

Jujeni të inkurajuar të përdorni manualin e PIP-it që ofron udhëzimet për procedurat e vlerësimit dhe planifikimit të projekteve, buxhetimin e fondeve kapitale dhe monitorimin e

implementimit të projekteve. Doracakun e PIP-it mund ta gjeni në ueb-faqen: www.pip-ks.org.

Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit (SZHMB – BDMS)

Siç është e njohur Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit është sistem financiar i cili merret me formulimin e buxhetit dhe planifikimin e shpenzimeve për të gjitha kategoritë ekonomike operative (numri i stafit dhe shpenzimet e tyre, pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, shpenzimet komunale, subvencionet dhe transferet si dhe kategoria e rezervave).

Që tani Sistemi SZHMB është në dispozicion për shfrytëzim nga organizata e juaj buxhetore. Kërkesat e para do të futën në Format e tanishme standarde.

Organizatat buxhetore janë të detyruara që të respektojnë kufijtë e lëshuar me Qarkoren e parë buxhetore. Sistemi i SZHMB dhe sistemi i PIP-it nuk do të lejojnë në asnjë rast tejkalim të kufijve të lëshuar me qarkoren e parë buxhetore.

Një manual përdorimi i SZHMB mund të merret direkt nga Ueb-faqja www.bdms-ks.org

Gjatë plotësimit të PCF2 për stafin do të plotësohen fushat me koficientat që janë ekzistues kurse zyrtarët që nuk mund të gjejnë pozitën në koficientat ekzistues duhet të plotësojnë ato fusha që janë të shtuar si me përshkrimin „Personeli i pa kategorizuar 1”, e në vazhdim me numër rendor. Këto fusha plotësohen në mënyrë manuale.

Të gjitha këto planifikime për staf duhet bëhen brenda kufijve buxhetor.

Nëse paraqiten pyetje lidhur me udhëzimet në këtë qarkore, organizatat buxhetore duhet të ndjehen të lira të konsultohen me analistët e tyre në kuadër të Departamentit të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave (MF).

Organizatat buxhetore kërkesat e tyre duhet ti dërgojnë më së largu më 20 Qershor 2014 në Departamentin e buxhetit në tri gjuhë: shqipe, serbe dhe angleze. Materialet dorëzohen në kopje fizike dhe elektronike.

Kërkesa Formale për Buxhet


Të gjitha kërkesat për Buxhet duhet të dorëzohen të shtypura në letër, në Ministrinë e Financave, ndërtesa e Qeverisë.

Kërkesa për buxhet duhet të përfshijnë:

Tabela 3.1 e shtypur nga sistemi BDMS,

Tabela 3.2 e shtypur nga sistemi PIP, dhe

Letër kërkesa (shkresa përcjellëse) e firmosur / nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm apo Kryeshefi i agjensionit.



Me respekt,
Besim Beqaj
Ministër

Aneksi 1: Kufijt filletar për Buxhetin e vitit 2015 dhe vlerësimet përvitet 2016 - 2017 (në euro)

	Ministratë/Institucionet	Punëtor	Buxheti 2015						Vlerësimet përvitin 2016	Vlerësimet përvitin 2017
			Paga dhe Mëditje	Malra dhe Shërbime	Shpenzimet Komunale	Subvençione dhe Transfere	Shpenzimet Kapitale	Rezerva	Total 2015	
101	Kuvendi i Kosovës	338	6,556,332	1,318,201	187,850	30,000	830,000	-	8,922,383	7,802,383
102	Zyra e Presidentit	70	694,504	861,472	18,700	70,000	100,000	-	1,744,676	1,744,676
104	Zyra e Kryeministrit	642	3,600,743	2,914,624	203,828	1,480,000	3,810,994	-	12,010,190	11,310,190
201	Ministria e Financave	1,704	8,168,543	7,245,819	488,592	36,594,800	3,696,868	-	129,711,622	130,416,705
202	Ministria e Administrimit Publik	266	1,782,249	4,892,132	1,139,600	50,000	13,791,596	-	21,655,577	22,735,577
203	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	323	1,939,278	2,808,033	108,768	53,573,922	1,570,000	-	60,000,000	60,000,000
204	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	207	1,108,608	1,935,744	89,280	-	-	1,100,000	4,233,632	4,233,632
205	Ministria e Infrastrukturës	266	1,283,930	6,592,756	205,190	1,853,814	170,055,172	-	179,990,862	177,860,862
206	Ministria e Shëndetësisë	7,758	45,033,969	36,094,338	3,831,964	1,703,725	18,000,000	-	104,663,996	104,663,996
207	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	654	2,890,112	917,406	324,323	5,356,550	12,198,684	-	21,597,075	22,547,075
208	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	1,384	10,260,333	9,435,232	943,259	4,189,926	21,790,000	-	46,618,750	40,027,228
209	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	944	4,134,642	2,468,892	407,085	288,762,431	2,359,000	-	298,132,051	307,819,551
210	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	293	1,442,857	1,093,957	83,220	-	25,331,813	27,951,847	41,652,290	41,652,290
211	Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit	99	526,158	380,000	46,154	300,000	6,000,000	-	7,252,312	7,252,312
212	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	141	756,746	277,104	25,500	437,249	3,500,000	-	4,996,599	4,996,599
213	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	153	845,175	4,363,669	36,210	12,833,870	9,996,302	-	28,075,226	29,645,373
214	Ministria e Punës së Brendshme	10,275	59,304,289	21,524,469	1,878,180	1,318,870	18,896,605	-	102,922,413	101,262,413
215	Ministria e Drejtësisë	1,926	9,870,908	4,882,968	703,169	50,000	1,522,500	-	17,029,545	17,029,545
216	Ministria e Punës së Jashtme	272	6,815,490	10,058,428	796,051	100,000	1,741,164	-	19,511,133	19,511,132
217	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës	3,324	17,284,415	8,421,732	758,350	-	14,581,000	-	41,045,497	40,985,997
218	Ministria për Integrimin Evropiane	85	562,603	1,065,753	25,500	50,000	-	-	1,703,856	1,572,140
219	Ministria e Diasporës	66	413,460	1,227,239	25,500	130,000	-	-	1,796,199	1,637,019
230	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	33	202,611	667,210	8,200	-	-	878,021	328,021	328,021
231	Akademia e Shkencave ilite Arteve	55	636,000	411,500	5,000	-	-	-	1,052,500	1,052,500
235	Autoriteti i Rregulatorit i Komunikimeve Elektronike dhe Postar	39	309,088	327,395	12,700	-	75,000	-	724,183	749,183
236	Ajencionioni Kundëri-Korrupsion	40	293,709	154,097	8,500	-	-	-	456,306	456,306
238	Zyra Rregulatorit për Energji	33	372,456	200,700	22,000	-	40,000	-	635,156	635,156
240	Organzi Shqyrtyres i Prokurimit	23	163,865	114,355	5,100	-	-	-	283,320	283,320
241	Ajencionia për Ndilimë Juridike Falas	22	138,266	128,286	11,917	-	-	-	278,469	278,469
242	Universiteti i Prishtinës	2,230	16,175,632	3,256,233	868,012	1,314,000	3,449,462	-	25,063,339	25,063,339
243	Gjykata Kushtetuese e Kosovës	61	859,439	494,956	9,350	-	23,400	-	1,387,145	1,413,745
244	Komisioni Kosovar i Konkurençës	23	166,616	70,318	4,845	-	-	-	241,779	241,779
245	Ajencionioni Kosovar i Intellegjencës	90	3,000,000	765,000	68,000	450,000	1,500,000	-	5,783,000	5,783,000
246	Këshilli i Kosovës për Trashigimi Kulturore	16	77,718	68,410	2,550	-	-	-	148,678	148,678

Aneksi 1: Kufijt filletar për Buxhetin e viti 2015 dhe vlerësimet përvitet 2016 - 2017 (në euro)

	Ministratë/Institucionet	Punëtor	Paga dhe Mëditje	Mallra dhe Shërbime Komunale	Shpenzimet dhe Transfere	Rezerva	Total 2015	Vlerësimet përvitet 2016	Vlerësimet përvitet 2017
247	Paneli Zgjedhor per Ankesa dhe Panashtesa	20	160,184	84,674	7,820		252,678	252,678	252,678
249	Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Sherbinin Civil të Kosovës	26	193,351	52,402	3,825		249,578	249,578	249,578
250	Prokurori i Shtetit	641	4,842,877	1,414,624	199,630	-	6,587,131	6,527,131	6,587,131
302	Zyra e Auditorit Përgjithshëm	146	1,349,253	604,775	34,000	-	1,988,028	1,988,028	1,988,028
313	Zyra Rregullative e Ujët dhe Mbeturinave	21	194,450	133,365	6,503		334,318	334,318	334,318
314	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	20	174,633	123,732	11,900		310,265	310,265	310,265
317	Autoriteti i Aviacionit Civil	27	492,508	233,181	13,738		739,426	739,426	739,426
318	Komisioni i Pavarur i Minerave dhe Mineralave	79	645,801	402,699	30,600	20,000	50,000	1,149,100	1,239,100
319	Komisioni i Pavarur i Medave	31	373,769	336,405	17,000		400,000	1,127,174	727,174
320	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	88	582,937	374,904	46,791	4,200,000		5,204,632	5,204,632
321	Institutioni i Avokatit të Popullit	63	596,371	390,353	25,500	-	1,012,224	1,012,224	1,012,224
322	Instituti Gjyqësor i Kosovës	25	161,745	390,300	8,500	-	560,545	560,545	560,545
328	Këshilli Gjyqisori i Kosovës	2,118	13,509,921	3,711,599	515,929	250,000	2,000,000	19,987,449	19,987,449
329	Agjencija Kosovare i Pronës	242	956,462	539,774	82,333	94,000		1,672,569	1,672,569
251	Agjensioni Shtetëror përmjet Dhanave Personale	23	184,000	127,500	10,200		321,700	321,700	321,700
253	Agjencionii për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale	9	57,068	25,500	4,250	2,000,000		2,086,818	86,818
232	Shpenzimet e Paparashikuara	-				5,000,000		5,000,000	5,000,000
252	Fondi Zhvillimor i Mirëbesimit					-			
248	Radio Televizioni i Kosovës				9,768,500		9,768,500	9,739,800	9,906,400
	Totali 2015		37,434	305,573,074	146,384,215	14,370,966	424,887,657	340,633,560	5,000,000
239	Agjencionii Kosovar i Privatizimit	218	3,286,391	6,366,992	98,000	80,000	80,000	9,911,383	5,446,711
	Rezervat e Pashpërndara							11,800,000	11,800,000
	Totali i përgjithshëm me AKP		37,652	308,859,465	152,751,207	14,468,966	424,967,657	340,713,560	16,800,000
								1,258,560,855	1,261,340,337
									1,260,670,757

Aneksi 2.

Kalendari buxhetor për përgatitjen e buxhetit 2015

Kalendari buxhetor për shtatë muajt e ardhshëm është prezantuar si më poshtë – tani për tani është “vlerësimi më i mirë” dhe mund t’u nënshtronhet ndryshimeve.

- 29 Prill – aprovimi i Kornizë Afatmesme të Shpenzimeve 2015-2017 nga Qeveria dhe dorëzimi i KASH-it në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
- 15 Maj- Lëshimi i Qarkores së parë buxhetore 2015/01. Kjo qarkore përmban udhëzimet për procesin buxhetor, kufijtë buxhetor, kalendarin buxhetor.
- 20 Qershor- Organizatat buxhetore dorëzojnë në MF kërkesat buxhetore sipas dokumentacionit përkatës, sipas programeve dhe kategorive ekonomike. Kërkesat buxhetore duhet të janë plotësish të arsyetuara përmes përdorimit të sistemit të BDMS-se dhe PIP-it.
- 27 Qershor- Departamenti i makroekonomisë paraqet kornizën e re makro-fiskale.
- 2 Korrik - Qarkore buxhetore 2015/02 do të lëshohet sipas nevojës dhe do të adresoj vetëm çështjet specifike të reja të cilat kanë rezultuar pas lëshimit të Qarkores së parë buxhetore.
- 14 Korrik- Nëse kërkohen informata shtesë sipas Qarkores së dytë buxhetore atëherë këto informata duhet të dorëzohen nga Organizatat buxhetore në Ministrin e Financave – Departamentin e buxhetit deri në këtë datë.
- 20 Gusht – 02 Shtator - Dëgjimet buxhetore (pas pranimit të materialeve nga organizatat buxhetore). Pjesëmarrës në dëgjime do të janë zyrtarët të organizatave buxhetore, stafi i MF, Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, përfaqësues të Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa. Orari i dëgjimeve buxhetore do ti bashkëngjitet Qarkores buxhetore 2015/02. Nëse është e mundur në këto dëgjime, do të shikohet mundësia e arritjes së marrëveshjes për shumat totale të buxhetit të organizatës suaj për vitin 2015.
- 8 Shtator, Departamenti i Makroekonomisë paraqet vlerësimet e fundit për indikatorët makro-ekonomik, posaçërisht indikatorët që lidhen me procesin buxhetor 2015-2017.
- 10 Shtator - 17 Shtator, konsultime në Qeveri për caktimin e kufijve final buxhetore.
- 19 Shtator, nxjerra e Qarkores së tretë buxhetore me kufijtë final buxhetor.
- 24 Shtator - 26 Shtator–Ankesat nga Organizatat Buxhetore.
- 29 Shtator - 01 Tetor - Takimet e Qeverise për ti shqyrtau ankesat e organizatave buxhetore.
- 13 Tetor, Drafti i parë i buxhetit në MF dhe dërgimi i këtij drafti në Qeveri.

- 14 Tetor –29 Tetor - miratimi final i Draft Buxhetit në Qeveri.
- 31 tetor - Dorëzimi i Draft Buxhetit 2015 në Kuvendin e Republikës së Kosovës për Aprovim deri në datën e specifikuar në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.